



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2023, merr këtë

**V E N D I M  
PËR NDARJEN E MJETEVE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETIT  
“3X3 PRISHTINA FIBA CHALLENGER”**

**I.**

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktivitetit “3X3 Prishtina Fiba Challenger”.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 40,000.00 € ( dyzet mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

**III.**

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, të cilën Komuna e Prishtinës e bën për organizimin e aktivitetit “3X3 Prishtina Fiba Challenger”.

**IV.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Sportit dhe Drejtoria e Financave.

**V.**

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-451/01-86565/23, më 02.05.2023**

**KRYESUESI I KUVENDIT  
Fehmi Kupina**

